



### *VENDIM*

*Nr. 150 Datë 30.12.2013*

### **MBI**

## **PROKURIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES, QË NUK MBULOHET NGA PROKURIMI VJETOR**

Në mbështetje të pikës 4.8 të Modelit të Tregut, miratuar me VKM nr. 338 datë 19.03.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 30.12.2013, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoritë Teknike, lidhur mbi përgjegjësinë e OSSH sh.a për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes,

### **Konstatoi se:**

- OSSH është përgjegjëse për importin e energjisë elektrike për të mbuluar të gjitha humbjet në sistemin e shpërndarjes;
- Kompania është vendosur në administrim të përkohshëm sipas nenit 18, pika 4, gërma “c” të Ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”,
- Humbjet faktike në sistemin e shpërndarjes përlogariten rreth datës 14 të muajit pasardhës, që shkakton një mospërputhje me planifikimit vjetor dhe humbjeve faktike në sistem ,

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

***Vendosi:***

1. CEZ Shpërndarje sh.a në administrim të përkohshëm, për nevoja të mbulimit të plotë të humbjeve në sistemin e shpërndarjes, të realizojë blerjet e energjisë elektrike mbi baza mujore për sasinë e energjisë elektrike që nuk mbulohet nga prokurimi vjetor.
2. CEZ Shpërndarje për prokurimin e energjisë elektrike mbi bazë mujore duhet të zbatojë procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Prokurimit të Energjisë Elektrike nga ana e OSSH, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 42 date 25.05.2009.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë OSSH sh.a për vendimmarrjen e ERE-s.

Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.